

Kosovë 2009

ANALIZA TË MIKROFINANCËS DHE RAPORTI I KRAHASIMIT

Raport nga Microfinance Information Exchange (MIX)
dhe Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës (AMIK)

Janar 2010

PËRMBLEDHJE

Sektori mikrofinanciar ka vepruar në Kosovë nga viti 1999, dhe shumica e Institucioneve Mikrofinanciare (IMF-ve) filluan si programe të zhvillimit ekonomik të organizatave humanitare ndërkombëtare.

Aktualisht janë 14 IMF që veprojnë kryesisht në zonat rurale, përfaqësojnë 18 përqind të sektorit financiar në numrin e kredive dhe 7 përqind në shumën totale të kredive. Këto shifra dëshmojnë një numër të madh të kredive të shpërndara në shumata të vogla (shiko **Tabelën 1**).




TABELA 1 STATISTIKAT E OFRUESËVE TË MIKROFINANCAVE DHE BANKAVE KOMERCIALE DERI NË SHTATOR 2009

Institucioni	Organizata amë	Numri i degëve	Huamar-rësit aktiv	Portfolio e kredisë (euro)	Bilanci mesatar i kredive (euro)	Shkalla e depërimit
KEP Trust	Intl.Catholic Migration Committee	33	19,287	43,717,000	2,267	1.9%
FINCA	FINCA	7	12,218	17,694,000	1,448	1.2%
KRK	ADIE International	6	6,823	14,055,307	2,060	0.7%
KGMAMF	Grameen Trust	4	5,980	4,904,000	820	0.6%
AFK	Mercy Corps	6	3,609	6,766,000	1,875	0.4%
KosInvest	World Vision	3	2,271	2,289,000	1,008	0.2%
BZMF	World Relief	6	2,056	4,234,000	2,059	0.2%
START	Islamic Relief	2	1,434	877,000	612	0.1%
MESHTEKNA		2	380	383,000	1,008	0.0%
Qelim Kosovë	CELIM Italy	1	192	293,000	1,526	0.0%
Perspektiva 4		1	100	94,000	940	0.0%
Atlantic Capital Partners		1	62	402,000	6,484	0.0%
CORDAID	CORDAID	1	15	116,000	7,733	0.0%
Kosova Aid and Development		1	13	18,000	1,385	0.0%
Total		74	54,440	95,842,307	1,761	5.5%
Pro Credit Bank - Kosovo	ProCredit Holding	60	96,172	465,647,490	4,842	9.7%
<i>Të gjitha bankat tjera komerciale në Kosovë (7 gjithsejt)</i>		235	160,602	789,126,915	4,914	N/A

Burimet: AMIK, 2009, Anëtarët e AMIKut përfshijnë: Agjencioni për financim në Kosovë (AFK), Besëlidhja/Zavet Microfinance (BZMF), FINCA -Kosovo, Kosovo Enterprise Program (KEP Trust), Kosovo Grameen Mission Arcobaleno Micro Credit Fund (KGMAMF), KosInvest, Kreditimi Rural i Kosovës (KRK), QELIM Kosova, START


MIKROFINANCA NË KOSOVË: TREGUESIT KRYESOR 2008

FIGURA 1 TRENDET E PËRFSHIRJES DHE SHKALLËZIMI PËR IMF-TË JO-BANKARE NË KOSOVË, 2006-2009




Burimet: 2006-2008. Statistikat Kuartale të AMIK-ut. Rezultatet janë totale e grupeve të ngjashme.

FIGURA 2 BILANCI MESATAR I KREDIVE PËR HUAMARRËS, 2006-2008




Burimet: MIX Market, 2006-2008. Rezultatet janë mesataret e grupeve të ngjashme.

FIGURA 3 FINANCIIMI I PORTFOLIOSË SË KREDIVE PËR IMF-TË NË KOSOVË



Burimet: MIX Market, 2006-2008. Rezultatet janë mesataret e grupeve të ngjashme.

FIGURA 4 PËRBËRJA E HUADHËNËSVE TË KOSOVËS DHE GRUPEVE TË NGJASHME, 2008




Burimi: Databaza e Strukturës së Financimit, 2008. Rezultatet janë për totale e grupeve të ngjashme. IFZH=Institucion Financiar Zhvillimor, Privat=Fondacioni/OJQ

TABELA 2 KOSTOT DHE KUSHTET E BORXHIT NË KOSOVË, BALLKANI DHE BDHEH, 2008

	Kosova	Ballkani	BdheH
Mesatarja e Ponderuar e Normës së Interesit	7.7%	6.8%	6.9%
Mesatarja e Ponderuar e Maturimit në muaj	58	65	56


Burimi: Databaza e Strukturës së Financimit, 2008. Rezultatet janë për mesataren e ponderuar të grupeve të ngjashme.

FIGURA 5 SHPËRBERJA E KTHIMIT TË ASETEVË, KOSOVË 2006-2008




Burimi: MIX Market, 2006-2008. Rezultatet janë për mesataren e grupeve të ngjashme.

FIGURA 6 SHPËRBERJA E KTHIMIT TË ASETEVË, KOSOVA DHE GRUPET E NGJASHME.



Burimi: MIX Market, 2008. Rezultatet janë për mesataren e grupeve të ngjashme.

FIGURA 7 NDRYSHIMI NË EFIÇIENCË, DY PERSPEKTIVA



Burimi: MIX Market, 2006-2008. Rezultatet janë për mesataren e grupeve të ngjashme.

Kosova ka numrin më të madh të popullatës së varfër në Ballkan me një shkallë kombëtare të varfërisë prej 45 përqind (990,000 njerëz). Sektori mikrofinanciar jo-bankar ka një shkallë depërtimi¹ prej 5.5 përqind kundrejt 9.7 përqind që ka ProCredit Bank, që është banka më e madhe në Kosovë. Kështu, shkalla totale e depërtimit është rreth 15 përqind, që tregon se ka vend për rritje të sektorit në vitet e ardhshme. Nëse i krahasojmë, sektorët e tjerë mikrofinanciar në Ballkan kanë shkallë më të lartë të depërtimit: 84 përqind në Bosnje dhe Hercegovinë (BdheH), 35 përqind në Serbi dhe Mal të Zi dhe 23 përqind në Shqipëri.

ZHVILLIMET NË MJEDISIN LIGJOR DHE RREGULLATIV

Në fazën fillestare të veprimit të tyre, IMF-të janë regjistruar si OJQ të rregulluara nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). IMF-të u regjistruan në Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe fitimi i tyre ishte i liruar nga taksat. Në Mars 2008, UNMIK aprovoi Rregulloren 2008/28 mbi Regjistrimin, Licensimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Institucioneve Mikro-Financiare, duke iu mundësuar në këtë mënyrë IMF-ve të transformohen në entitete “ të licensuara” depozit -marrëse. IMF-të depozit-marrëse duhet të regjistrohen në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë si Shoqëri Aksionarësh (SHA) ose Kompani me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK). Rregullorja poashtu parasheh një nen për IMF-të që nuk kanë mundësi të plotësojnë kërkesat e kapitalit për Institucione depozit- marrëse, të bëhen Institucione të “regjistruara”. IMF-të e regjistruara mund të vazhdojnë funksionimin si OJQ duke dhënë kredi mikrofinanciare si produkt të vetëm, përderisa IMF-të e licensuara mund të veprojnë si entitete komerciale dhe janë të lejuara që të mobilizojnë depozita prej publikut.

¹ Shkalla e depërtimit definohet si numri i huamarrësve të mikrofinancave pjesëtuar me numrin e njerëzve që jetojnë nën kufirin e varfërisë kombëtare. Janë shfrytëzuar statistikat e Bankës Botërore të nivelit të varfërisë.

Meqenëse shumica e IMF-ve janë themeluar përmes donacioneve, çështja e transferimit të aseteve prej OJQ-ve në entitete të reja të biznesit (SHA ose SHPK) dhe tatimi retroaktiv i IMF-ve në transformim, në raport me Statusin e Përfitimit Publik janë ende të debatueshme, që paraqet arsyen pse procesi i transformimit është bllokuar më tepër se një vit. Megjithatë, akterët e njohin faktin që transformimi do të jetë i dobishëm për sektorin mikrofinanciar, për trupat rregullativ dhe popullatën e Kosovës, ndërsa IMF-të do të kenë të definuar qartë strukturën e tyre të pronësisë, do të bëhen taksa pagues, dhe do të kenë mundësi të ofrojnë produktet të depozitave tek njerëzit me qasje të limituar në shërbimet financiare.²

PERFORMANCA FINANCIARE

Në fund të vitit 2008 dhe në vitin 2009, shumë IMF në regjionin e Evropës dhe Azisë Qendrore (EAQ) kanë përjetuar zvogëlim të shtrirjes (në disa raste për arsye të mbi-financimit të sektorit), rritje të delikucencës dhe humbje të mëdha të këmbimit të huaj, për shkak të ndikimit të krizës globale financiare dhe rënies së ekonomisë. Sektori mikrofinanciar në Kosovë ishte i mbrojtur nga shumica e këtyre rreziqeve, siç është demonstruar me rritje të fortë e të vazhdueshme në shtrirje, rritje të profitabilitetit dhe efijencës në 2008. Tregu në Kosovë është ende i ri dhe i pangopur, në këtë mënyrë iu mundëson IMF-ve të rriten. Për më tepër, IMF-të nuk janë të ekspozuara ndaj rrezikut të këmbimit të jashtëm, pasi që valuta vendore është Euro dhe shumica e huave të IMF-ve janë të vlerësuar në Euro. Megjithatë, ekonomia e Kosovës është shumë e varur në remitenca, që përbëjnë 14 përqind të GDP-së, dhe këto pritet të zvogëlohen kur numri i punëtorëve Kosovar në Evropën Perëndimore fillon të ndjen ndikimet e krizës.

² AMIKu ka organizuar një punëtori në Nëntor 2009 për Transformimin e IMF-ve në Kosovë me 84 pjesëmarrës (investitorët ndërkombëtar, rregullatorët dhe autoritetet shtetërore) që të adresojnë këto çështje. Grupi punues ishte themeluar që të ofrojë zgjidhje. Termat e referencës për Grupin Punues u nëshkruan nga tri Institucione Qeveritare: Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Administratës Publike dhe Banka Qendrore e Kosovës dhe do të përbëhet nga përfaqësuesit e këtyre tri Institucioneve duke përfshirë AMIK-un.

Pasi që shumica e klientëve të mikrofinancave nuk janë të punësuar formalisht dhe mbështeten në të ardhurat nga familjarët nga jashtë që të zbusin rrjedhën e tyre të parasë, rreziku kreditor për IMF-të Kosovare pritet të rritet në 2009.

Trendet për IMF-të e Kosovës tregojnë se rritja e fortë dhe e vazhdueshme në shtrirje ka vazhduar në 2008 dhe në 2009 (shiko **Figurën 1**). IMF-të kanë rritur bazën e huamarrësve për 20 përqind në 2008 dhe 27 përqind deri më 31 Tetor 2009. Megjithatë, rritja e portfolios ishte më e ngadalshme, krahasuar me rritjen prej 41 përqind në 2008 kundër vetëm 15 përqind në çerekun e tretë të 2009. Zvogëlimi i remitencave në Kosovë ka reduktuar fuqinë blerëse të klientëve, dhe si rezultat IMF-të u bënë më konservative në huadhënie duke shpërndarë kredi më të vogëla – treguesi mesatar për bilancin mesatar të kredive për huamarrës ka pësuar rënie prej 2,023 euro (USD 2,810) në 2008 në 1,904 euro (USD 2,644) në 2009, përderisa në vitet e mëparshme ka patur rritje të vazhdueshme (shiko **Figurën 2**).

Rritja e fuqishme e IMF-ve në Kosovë është mundësuar nga një fluks i investimeve të borxheve të jashtme. Totali i huave në vijim është rritur për 234 përqind nga 2005, duke shkuar prej 23 në 77 milion USD. Huatë e IMF-ve kanë financuar mbi 60 përqind të portfolios së kredive në 2008 kundër 39 përqind në 2006 (shiko **Figurën 3**). Meqenëse IMF-të kanë financuar një pjesë të madhe të portfolios së tyre nga borxhi komercial, koeficienti i shpenzimeve financiare është ngritur nga 2 përqind në 2006 deri në 5.5 përqind në 2008. Përbërja e huadhënësve aktiv në Kosovë është e njëjtë me ato IMF tipike në EAQ, por IMF-të tjera të ngjashme në Ballkan, posaçërisht B dhe H, marrin një të tretën e borxhit të tyre prej bankave vendore (shiko **Figurën 4**). IMF-të në Kosovë huazojnë më së shumti nga investitorët ndërkombëtarë –70 përqind e të gjitha huazimeve vijnë nga fondet investive mikrofinanciare (të njohura me emrin fondet) – pasi që ato ofrojnë kushte më të favorshme se sa bankat vendore. Megjithatë, pasi që investitorët komercial kanë hyrë më vonë në

këtë treg, normat e interesit dhe kushtet e kredive janë ende të larta se sa në vendet e tjera të nën-rajonit (shiko **Tabelën 2**).

Sa i përket profitabilitetit, IMF-të e Kosovës janë në një nivel me ato simotra në Ballkan, në Normën e Kthimit të Aseteve të rregulluar me 1.3 përqind, e cila ishte më e lartë se sa mesatarja e vendeve të EAQ-së me 0.3 përqind. Profitabiliteti i lartë është nxitur nga shpenzimet e zvogëluara përderisa të ardhurat nuk kanë lëvizur shumë – të ardhurat për 3 vitet e kaluara ishin 24 – 25 përqind në nivel të barabartë me Ballkanin dhe më të ulëta se sa në B dhe H (shiko **Figurën 5**). Koeficienti i shpenzimeve totale ka pësuar rënie nga 21 përqind në 2006 në 19 përqind në 2008, kryesisht i nxitur nga zvogëlimi i shpenzimeve operative dhe shpenzimeve të provizionimit (shiko **Figurën 6**). Përveç kësaj, duke i krahasuar me të tjerët (posaçërisht në B dhe H) shpenzimet e provizionimit të IMF-ve nga Kosova janë më të ulta, duke treguar një nivel më të ulët të rrezikut me të cilin ata ballafaqohen.

Sa i përket efijencës që matet nga shpenzimet operative ndaj portfolios së kredive, IMF-të e Kosovës janë ende nën nivelin e normave për Ballkanin. Megjithatë, treguesit kanë shkuar poshtë prej 2006, duke treguar përmirësim të efijencës (shiko **Figurën 7**). Kjo nuk ishte vetëm që të përfitojnë nga kursimi në rritje kur portfolio e kredive rritet ndërsa kostot fikse mbesin të njëjta, por gjithashtu përmirëson efijencën e stafit, siç është evidentuar në zvogëlimin e kostos për huamarrës në 2008 (ky tregues rritet për IMF-të tjera në 2008). Përfundimisht, në 2008 niveli i rrezikut për IMF-të e Kosovës ishte më i ulët në mesin e IMF-ve tjera të ngjashme, me portfolion në rrezik (PAR) mbi 30 ditë nga 1.2 përqind kundër 2.2 përqind në Ballkan dhe 2.5 përqind në B dhe H.

Viti 2009 do të jetë një vit më sfidues për IMF-të e Kosovës ku efektet e ngadalësimit ekonomik i prekin më tepër klientët e mikrofinancave. Niveli i rrezikut është rritur; prej Nëntorit 2009 (PAR) mbi 30 ditë ishte 4.6 përqind por ende ishte më e ulët se

sa Bosna, ku kishte arritur në 7 përqind. Si rezultat pritet të rriten shpenzimet e provizioneve. Në të njëjtën kohë, eficienta mund të jetë më e ulët në 2009, për shkak të zvogëlimit të rritjes së portfolios. Megjithatë, ndryshe nga IMF- të tjera të ngjashme të regjionit të EAQ-së dhe në Ballkan, IMF-të e Kosovës kanë mbajtur një rritje të vazhdueshme në shtrirje, vazhdojnë të jenë fitimprurëse dhe së shpejti

do të kenë edhe mundësinë të marrin depozita, që do t'i lehtësojë disa nga rreziqet e financimit të tyre.

Ralitsa Sapundzhieva
Lead Analyst, Eastern Europe and Central Asia,
MIX

Blerta Qerimi,
AMIK Director

6 Kosovë 2009 Analiza të Mikrofinancës dhe Raporti i Krahasimit

KRAHASIMET, KOSOVË 2009								
(Të gjitha shifrat janë " mesatare")	Krahasimet				Indikatorët e trendit (të papërshtatura)			
	EAQ	Kosova	Balkani	BdheH	Kosova 2008	Kosova 2007	Kosova 2006	
KARAKTERISTIKAT INSTITUCIONALE								
Numri i IMF-ve	218	7	35	12	6	6	6	
Mosha	9	8	9	11	8	7	6	
Asetet totale	4,766,477	9,368,387	50,434,230	56,655,094	13,348,744	10,977,744	8,063,569	
Nr. i zyreve	6	8	18	34	9	7	8	
Stafi	34	36	148	165	39	43	30	
STRUKTURA E FINANCIMIT								
Koeficienti i Kapitalit/Aseteve	22.8%	36.1%	24.9%	22.2%	34.4%	26.2%	58.9%	
Borxhet ndaj kapitalit	2.9	1.8	3.0	3.5	1.9	3.4	0.7	
Depozitat ndaj kredive	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	
Depozitat ndaj asetëve totale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	
Portfolio ndaj asetëve	88.0%	94.3%	91.7%	92.3%	94.9%	84.8%	89.8%	
INDIKATORËT E PËRFSHIRJES								
Numri i humarrësve aktiv	2,163	5,704	12,863	29,786	4,484	3,752	3,809	
Përqindja e femrave huamarrëse	43.0%	34.3%	41.6%	42.1%	29.3%	23.3%	22.2%	
Numri i kredive në vijim	2,266	5,704	13,320	33,475	4,484	3,752	3,809	
Bruto portfolio i kredive	3,951,943	8,830,199	41,314,440	52,126,390	12,682,392	9,378,592	7,079,227	
Bilanci Mesatar i Kredive për Huamarrës	2,177	2,747	2,679	1,858	2,811	2,559	2,059	
Bilanci Mesatar i Kredive për Huamarrës/ GNI për kokë banori	68%	186%	77%	49%	191%	174%	140%	
Bilanci Mesatar në vijim	2,120	2,747	2,521	1,800	2,811	2,559	2,059	
Bilanci Mesatar në vijim /GNI për kokë banori	66%	186%	76%	48%	191%	174%	140%	
Numri i depozituesëve vullnetarë	0	0	0	0	0	0	0	
Numri i llogarive të depozituesëve vullnetarë	0	0	0	0	0	0	0	
Depozitat Vullnetare	0	0	0	0	0	0	0	
Bilanci Mesatar i Depozitave për depozitues	0	0	0	0	0	0	0	
Bilanci Mesatar i Depozitave për depozitues/ GNI për kokë banori	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%	
Bilanci Mesatar i llogarive depozituese	0	0	0	0	0	0	0	
Bilanci Mesatar i llogarive depozituese / GNI për kokë banori	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%	
INDIKATORËT MAKROEKONOMIK								
GNI për kokë banori	3,780	1,474	3,595	3,780	1,474	1,474	1,474	
Shkalla e rritjes së GDP-së	8%	11%	7%	7%	11%	11%	11%	
Shkalla e depozitave	5.4%	4.0%	4.0%	3.6%	4.0%	4.0%	3.1%	
Shkalla e inflacionit	9.0%	4.4%	3.2%	1.3%	4.4%	4.4%	0.6%	
Qasja në financim	42.9%	0.0%	64.6%	65.9%	0.0%	0.0%	0.0%	
PERFORMANCA E PËRGJITHSHME FINANCIARE								
Kthimi në asete	0.3%	1.3%	1.6%	4.2%	2.6%	2.0%	3.5%	
Kthimi në kapital	2.9%	3.9%	8.0%	15.5%	5.9%	4.2%	6.7%	
Vetë-qëndrueshmëria operative	117.1%	113.3%	113.3%	121.5%	113.3%	111.0%	129.1%	
Vetë-qëndrueshmëria financiare	104.3%	106.5%	110.1%	123.2%	N/A	N/A	N/A	
TË ARDHURAT								
Të ardhurat financiare/Asetet	24.4%	21.9%	20.8%	27.2%	22.7%	21.6%	22.3%	
Marzha e profitit	4.0%	6.1%	9.1%	18.8%	11.7%	9.9%	19.1%	
Të ardhurat për Portfolion Bruto (nominale)	29.4%	23.2%	23.0%	26.4%	24.8%	23.3%	24.9%	
Të ardhurat për Portfolion Bruto (reale)	19.3%	18.0%	18.3%	24.6%	19.5%	18.1%	24.2%	
SHPENZIMET								
Shpenzimet totale/Asetet	24.2%	20.5%	18.4%	20.5%	19.3%	19.4%	20.9%	
Shpenzimet financiare/Asetet	8.9%	5.5%	6.2%	6.5%	5.5%	3.6%	2.0%	
Provizionimi i dëmeve për Kredi/Asetet	1.3%	0.7%	1.5%	3.7%	0.7%	1.0%	2.3%	
Shpenzimet Operative/Asetet	12.8%	12.7%	10.8%	11.0%	14.7%	16.2%	15.7%	
Shpenzimet e Stafit/Asetet	7.2%	7.2%	5.8%	6.5%	7.8%	7.7%	7.7%	
Shpenzimet Administrative /Asetet	5.1%	5.6%	4.6%	4.0%	6.0%	7.5%	8.0%	
Shpenzimet e përshtatura/Asetet	2.0%	0.7%	0.5%	0.3%	N/A	N/A	N/A	
EFIÇIENCA								
Shpenzimet Operative/Portfolios së kredive	15.0%	13.7%	12.6%	12.1%	15.5%	18.3%	18.8%	
Shpenzimet e stafit / Portfolios së kredive	8.2%	8.2%	7.2%	7.2%	8.9%	9.0%	9.2%	
Paga Mesatare /GNI për kokë banori	390.0%	1008.0%	552.0%	550.0%	1082.0%	1163.5%	867.0%	
Kosto për huamarrës	309	398	313	217	419	458	338	
Kosto për kredi	289	398	313	213	419	458	324	
PRODUKTIVITETI								
Huamarrësit për anëtar të stafit	58	70	104	145	68	69	82	
Kreditë për anëtar të stafit	59	70	104	146	68	69	82	
Huamarrësit për Zyrtar Kreditor	167	189	209	228	161	143	176	
Kreditë për Zyrtar Kreditor	169	189	211	231	161	143	176	
Depozituesit Vullnetar për Anëtarë të stafit	0	0	0	0	0	0	0	
Llogaritë Depozituese për Anëtarë të stafit	0	0	0	0	0	0	0	
Koeficienti për Alokim të stafit	37.0%	42.4%	52.5%	64.8%	40.2%	48.0%	58.4%	
RISKU DHE LIKUIDITETI								
Portfolio në risk > 30 Ditë	2.0%	1.2%	2.2%	2.5%	1.5%	1.5%	2.0%	
Portfolio në risk > 90 Ditë	1.0%	0.6%	1.2%	1.0%	0.6%	0.8%	1.0%	
Koeficienti i Kredive të Shlyera	0.4%	0.7%	1.2%	1.5%	0.7%	1.3%	1.9%	
Koeficienti i Kredive të humbura	0.3%	0.6%	0.9%	1.2%	0.3%	1.1%	1.7%	
Koeficienti i Mbulimit të Riskut	78.0%	92.9%	89.0%	88.7%	92.9%	118.1%	99.9%	
Asetet likuide jo-fitim prurëse si % e Aseteve totale	5.5%	3.4%	6.0%	4.5%	3.2%	11.9%	9.2%	